



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo–Republic of Kosovo**  
**Kuvendi – Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr. 105/2013  
Prishtinë, më 15.05.2013, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, sala S–II

**P R O C E S V E R B A L**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,**  
**TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

**Munguan:** Fikrim Damka dhe Ramiz Kelmendi.

**Pjesëmarrës i ftuar:** Enver Halimi, kryesues i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji – ZRRE-së.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Merita Kostari, Krenar Bujupi dhe Ejup Hasolli - ZRRE; Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi – INDEP dhe Shefki Kastrati – NDI.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e kryesoi:** Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 07.05.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit;
5. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik;
6. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** – I njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk i kanë shqyrtuara ende raportin më propozim amendamente, edhe pse ka kaluar afat i paraparë më Rregullore dhe për të mos shkaktuar paqartësi në seancë propozoi që të shtyhen për mbledhjen e radhës.

*Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetarit.*

*Rendi i ditës u miratua më heqjen e pikës 4 ( katër ) dhe 5 (pesë ).*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 07.05.2013**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 07.05.2013 u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2012**

**Kryetari** – Theksoi se ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2012. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e - ZRRE-së, z Enver Halimi, i cili do të paraqesë një ekspozë të shkurtër për këtë Raport dhe pastaj të hapet debat.

**Enver Halimi, kryesues i Bordit i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE-** I njoftoi deputetët se Raporti paraqet një pasqyrë të aktiviteteve të zhvilluara dhe arritjeve kryesore të ZRRE-së, dhe të sektorit të energjisë gjatë vitit kalendarik 2012. Raporti përmban informacione për ngjarjet më të rëndësishme për tregun e energjisë, shqyrtimin e tarifave të energjisë, raportin financiar të ZRRE-së, si dhe të dhëna për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2012 janë harmonizuar të gjitha licencat ekzistuese për aktivitete të energjisë bazuar në harmonizimin e legjislacionit sekondar të ZRRE-së. I tërë ky proces është zhvilluar në konsultim me palët e treta dhe publikun. Pamjaftueshmëria e kapaciteteve gjeneruese ekzistuese për të plotësuar nevojat e furnizimit dhe nevoja për investime në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, kërkon iniciimin e një ristrukturimi të sektorit të energjisë përmes liberalizimit të tregut dhe rritjes së konkurrencës në tregun e energjisë elektrike. Për të arritur këto objektiva në proces të finalizimit është krijimi i Dizajnit të Tregut i cili së shpejti pritet të aprovohet nga ZRRE. Qeveria e Kosovës tanimë ka përmbyllur procesin e projektit për privatizimin e shpërndarjes dhe furnizimit të cilat aktualisht janë në kuadër të KEK-ut. Në sistemin e transmissioinit janë kryer investime të rëndësishme që kanë rezultuar me zvogëlimin e fyteve të ngushta, me përmirësimin e cilësisë së furnizimit dhe me zvogëlim të humbjeve në transmissioin. Gjendja e rrjetit të shpërndarjes mbetet jo e mirë për shkak të investimeve jo të mjaftueshme, me humbje të mëdha teknike e komerciale të energjisë dhe me pa mundësi të sigurimit të furnizimit cilësor të konsumatorëve me energji elektrike. ZRRE edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar me procesin e monitorimit të të licencuarve dhe të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe rregullave në fuqi, me qëllim të ngritjes së nivelit të cilësisë së furnizimit dhe shërbimit të konsumatorëve. Edhe sektori i ngrohjes qendrore gjatë sezonit 2011/2012, karakterizohet përgjithësisht me furnizim të çrregulluar dhe me ndërprerje të shpeshta në periudha kohore disaditëshe. ZRRE ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (KEJL) në të grupet punuese, si dhe të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë (ECRB).

**Kryetari** – Tha se ky raport është i një cilësie të mirë, por mbetet ende sfida për bordin edhe stafin e ZRRE-së që të punojë më shumë në përmbushjen obligimeve ligjore dhe në zbatimin e legjislacionit sekondare që dalin nga Ligji për rregullatorin energjisë.

**Visar Ymeri** - Kërkoi që të sillet raport shtesë dhe të bazohen edhe në analizën që e ka bërë INDEPI. Tha që raporti ka nevojë për t' u plotësuar me shumë më të dhëna në detaje së si janë zhvilluar proceset gjatë viti 2012. Pyeti se çka ka bërë ZRRE-ja gjatë viti 2012 për energjinë e ripërtëritur? Çka ka bërë ZRRE-ja gjatë viti 2012 për rritjen e çmimit të tarifave të energjisë elektrike? A ka pas ndikimi rritja e çmimit të tantumës në çmimin e energjisë elektrike? Dhe a do të këtë rritje të çmimit të tantumës për vitin 2013?

**Myzejene Selmani** – Tha që është një raport i mirë, por kërkoj nga përfaqësuesi i ZRRE-së që të sjellin në Komision edhe një raport shtesë më analiza krahasuese për çdo sektorë së çka është arritur dhe çka ka mbetur pa u realizuar. Pastaj parashtrroi disa pyetje pas privatizimit të distribucionit, a do të arrijë kompania që e ka privatizuar rrjetin e shpërndarjes t'i zvogëlojë humbjet teknike? Për humbjet nga ana e KOSST- it, gjatë transmissiionit të energjisë elektrike pse nuk janë zvogëluar humbjet? Çka po ndodh me shumën prej 17 milionë eurove që KEK-u po i kërkon nga ZRRE-ja t'i kenë në menaxhim? Dhe për zyrën për mbrojtje të konsumatorëve çka po ndodh më çështjen faktuarave?

**Teuta Sahatqija** – Tha se është njeri prej raporteve të agjencive që është analizuar më së shumti për vetë faktin që ka të bëjë drejtpërdrejt me të gjithë konsumatorët. Pyeti për çmimin e tarifave në raportin e ZRRE-së, ngase është thënë se ka pakënaqësi që nga viti 2007. A mendoni tani, Bordi i ZRRE-së, që duhet të rishikohen tarifat për shkak të vërejtjeve të shumta të konsumatorëve? Për energjinë alternative, që jemi të obliguar si shtet të prodhojmë deri në 20%, deri në vitin 2015; lidhur me liberalizimin e tregut pse jeni vonuar? Te njëjtorët digjital a janë të nevojshëm këta njëjtorë, pasi që për vitin 2015 është paraparë liberalizimi i tregut? Për kontestin gjyqësor në mes të KEK-ut dhe ZRRE-së për çështjen e shumës së mjeteve financiare prej 17 milionë eurove si qëndron puna?

**Hashim Deshishku** – Pyeti për çështjen e humbjeve në totale të energjisë elektrike se sa janë në Veri të Kosovës – Mitrovicës dhe sa janë në përqindje humbjet e përgjithshme?

**Lutfi Zharku** – Pyeti se cilat kanë qenë kriteret e ZRRE-së për caktimin e tarifave që i kanë aplikuar për rritjen e çmimit të energjisë elektrike? Për kategorinë e konsumatorëve që kanë harxhuar deri në 200 dhe mbi 200 KW a ka nxjerrë të dhëna ZRRE- ja se sa është numri i këtyre konsumatorëve? Si dhe parashtrroi pyetje për çështjen e bllok -tarifave duke kërkuar sqarime shtesë.

**Sala Berisha-Shala** - Tha se kërkesa për të sjellë raporte shtesë është e mirëseardhur për të vlerësuar së janë arritur planet dhe objektivat e ZRRE-së për shumë çështje që u hapën. Ajo kërkoi që dokumentet që aprovohen nga bordi i ZRRE-së duhet të jenë të detajuar së çka është aprovuar, ndërsa kur të këtë rritje të çmimit të tarifave duhet të këtë analiza pse është rritur çmimi i tarifës, po ashtu edhe për kapacitet prodhuese duhet të bëni krahasoni prej vit në vit. Pyeti për licencat që janë aktive se a ka pasur nevojë për t'i vazhduar dhe nëse po, pse? Si dhe kërkoj që tabelat të thjeshtohen, sepse janë shume teknike dhe të paqarta për publikun e gjerë.

**Shaip Muja** - Tha se ZRRE-ja dhe Ministra e Zhvillimit Ekonomik duhet të fokusohen në energjinë e ripërtëritur dhe në energjinë solare. Pasi që këto dy çështje janë edhe kriteret të Bashkimit Evropian. Pastaj parashtrroi pyetje se deri në çfarë mase është arritur riformulimi i çmimit për energjinë e prodhuar për disa vite në energjinë e ripërtëritur? Sepse investimet në

këtë fushë janë më rëndësi ekonomike dhe ekologjike. Pyeti se a ka ndonjë vërejtje nga aplikuesit për licenca në bazën ligjore për prodhimin energjisë me mbeturina se ku duhet të vendosen caqet? Për investimet e KEK-ut për njësorët elektronikë se çka nënkuptohet me këta njësorë që KEK-u duhet t'i mirëmbajë? Sepse mund të jetë problematike kjo për shkak se kemi të bëjmë më në njëjtin softuer. A ka do një vërejtje nga aplikuesit për licenca në bazën ligjore për prodhimin energjisë me mbeturina se ku duhet të vendosen caqet?

**Krenar Bujupi - anëtar i Bordit i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE** - Ju përgjigj pyetjeve që ngritën anëtarët e Komisionit. Sa i përket rritjes së çmimit të tarifave për vitin 2012 tha që Bordi i ZRRE-së është bazuar në ligjin për rregullatorin e energjisë dhe në metodologjinë e përcaktuar për tarafet. Rritja e çmimit të tarifave ka ardhur edhe si rezultat i reduktimit në masë të madhe të subvencionave nga ana e Qeverisë, po ashtu edhe rritje e tantumës ka dikuar në rritjen e çmimit të energjisë elektrike deri në 1%. Për humbjet tha që nuk janë zvogëluar nga ana e KEK-ut edhe pse është kërkuar nga ZRRE-ja që çdo viti duhet t'i ulin deri në 3% KEK-u ka arritur deri 1.8% t'i ulin. Për humbjet energjisë elektrike në veri të Kosovës, tha që niveli i humbjeve në tërë territorin e Kosovës në totalë është në 36.69 % por të dhëna të sakta për veriun e Kosovës duhet t'i nxjerrim, pastaj do t'ju dërgojmë në raportin shtesë, ndërsa për humbjet komerciale këto të dhëna i ka KEK-u, ku humbje teknike janë 16.32 % ndërsa humbje komerciale 20.37%. Për bllok - tarifën tha që ZRRE-ja shumë shpejt do të bëjë një analizë në detaje, dhe pastaj do t'i bëjmë publik në WEB- faqe të ZRRE-së. Për ndarjen konsumatorëve se kush sa harxhon në KEK, tha që nuk kemi të dhëna statistikore për ndarjen e tyre, por për këtë çështje do ta analizojmë për ta pasqyruar. Për kontestin gjyqësor në mes të KEK -ut dhe ZRRE-së për çështjen e shumës së mjeteve financiare prej 19 milionë eurove, tha që ky problem ka lindur kur KEK-u ka inkasuar mjete financiare më shumë se sa është paraparë, prandaj ZRRE-ja ka përgatitur që në planet e veta, vendos se sa duhet të inkasohet dhe këto mjete duhet përsëri t'ju kthen konsumatorëve. Për këtë çështje në po presim procesin gjyqësor për të marrë vendim se kujt i takojnë këto mjete buxhetore. Ai, po ashtu, njoftoi deputetët se për çështjen e biomasave shteti nuk jep subvencione, mirëpo tha se edhe për biomasë i kemi caqet.

**Merita Kostari, anëtare e Bordit i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE** – Foli për burimet e energjisë së ripërtëritur, tha që janë hartuar rregulloret në bazë të strategjisë për energjinë, dhe për këto burime duhet të plotësohen kushtet operative. Tha se Ministra e Zhvillimit Ekonomik i ka përgatitur caqet se ku mund të ndërtohen hidrocentralet me ujë, erë etj. Për çështjen e licencave ZRRE-ja në bashkëpunim me ministrin përkatës dhe komunat ka përgatitur aplikacionet dhe procedurat e aplikimit për licenca për të marrë pëlqimin mjedisore që nxisin investimet në sektorin e energjisë së ripërtëritur. Për prodhimin energjisë me mbeturina, tha që nuk është paraparë as nga MZHE-ja dhe ZRRE-ja pasi që është shumë e kushtueshme për ta prodhuar.

**Enver Halimi, kryesues i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji – ZRRE** - Në fund tha se do t'ju ofrojmë të gjitha të dhënat në detaje se si ka ecur procesi gjatë viti 2012 në ZRRE që nuk janë përfshirë në këtë raport dhe do t'ju sjellim edhe një raport shtesë më të dhëna ma të hollësishme për gjitha çështjet që u kërkuar.

**Kryetari** - Në fund të diskutimeve që bënë dhe përgjigjeve që morën deputetët lidhur me interesimin e tyre, raportin e ZRRE-së për vitin 2012 e vlerësoi pozitivisht. Por kërkoi që për të gjitha çështjet që u ngritën që të sjellët edhe një raport shtesë para së të procedohet raport për seancë plenare. Ai, po ashtu, në emër të Komisionit e inkurajoi kryesuesin, z. Halimi dhe Bordin e ZRRE-së që të vazhdojnë me këmbëngulësi për t'ju përmbajtur obligimeve ligjore dhe rregullave të rregullatorit të energjisë. Theksoi se për t'i tejkaluar sfidat që mund të paraqiten gjatë zbatimit të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë do t'ju ofrojmë mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit.

*Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë*

*Përfundim*

*Miratohet Raporti vjetor i punës së Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012.*

*Kuvendit ia paraqiti këtë*

*Rekomandim*

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i punës së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë vitin 2012.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

**4. Të ndryshme**

**Çështjet vijuese**

**Kryetari** – Propozoi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Raporti Vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës –AKK për vitin 2012.

*Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetarit.*

**Mbledhja përfundoi në orën 12:30.**

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetar i Komisionit**

---

**Zenun Pajaziti**